



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 6006

Prishtinë, Dt. 20/12/2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Biologji
Projektpropozimi	“Flora vaskulare natyrore drunore dhe shkurrore në Rrafshin e Drenicës” / “Natural woody and shrubby vascular flora in the Drenica Plain”
Kandidati	Diellza Gashi
Mentori	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 02.07.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 2273

Vlerësimi i dorëshkrimit

Shënimet e përgjithshme

Punimi i Masterit i kandidates Diellza Gashi përmban 53 faqe. Teksti është me rrallim normal. Punimi i ka 2 tabela dhe 21 figura. Në punim janë cituar 53 burime të literaturës. Punimi përmban **abstrakt** dhe **rezyme** në të dy gjuhët (shqip dhe anglisht). Në fund të punimit është **jetëshkrimi** i kandidates.

Punimi përmban: **Hyrje** (faqe 14-53), **Qëllimi** dhe **rëndësia e punimit** (faqe 16), **Të dhëna të përgjithshme për Rrafshin e Drenicës** (faqe 17-19), **Faktori antropogen** dhe **ndikimi i tij** (faqe 20),

**Flora dhe vegjetacionin i Rrafshit të Drenicës, vështrim i përgjithshëm** (faqe 21-22), **Materiali dhe metodat e punës** (faqe 23), **Rezultatet** (faqe 24-41), **Diskutim** (faqe 42-43), **Përfundime** (faqe 44), **Literatura** (faqe 45-48), **Rezyme** (faqe 49-50), **Summary** (faqe 51-52). **Jetëshkrimi** (faqe 53).

### **Analiza e Punimit**

Në **Hyrje** kandidatja përshkruan të dhëna përgjithshme për Kosovën, në veçanti për bimët drunore dhe shkurrore. Gjithashtu jepen të dhëna për bimësinë (florën dhe vegjetacionin e zonës së hulumtuar Rrafshit të Drenicës).

Te “**Qëllimi dhe rëndësia e punimit**” paraqiten arsyetime për qëllimin dhe rëndësinë e punimit.

Në kapitullin “Të dhëna të përgjithshme për Rrafshin e Drenicës”, sipas gjendjes në terren si dhe dhënavë nga literatura, shënohen të dhëna për pozitën gjeografike, përbërjen pedologjike dhe për kushtet klimatike të Rrafshit të Drenicës.

Bazuar në gjendjen në terren, “**Faktori antropogeni dhe ndikimi i tij**”, trajtohet në veçanti.

Në kapitullin “**Flora dhe vegjetacionin i Rrafshit të Drenicë, vështrim i përgjithshëm**” paraqiten informata për bimësinë (florën dhe vegjetacionin) e zonës së hulumtar.

Në pjesë të veçantë përshkruhen detaje për **materialin dhe metodat e punës**.

Pjesa (kapitulli) kryesore, sikur zakonisht në hulumtime, padyshim se është kapitulli “**Rezultatet**”. Rezultatet e hulumtimit paraqiten të detajuara. Prezantohen llojet e identikuara të bimëve nga grupi i florës vaskulare në Rrafshin e Drenicës. Grupet bimore si Tipet dhe Klasët janë renditur sipas filogenisë së tyre, përderisa grupet ose kategoritë tjera sistematike (familjet, gjinitë dhe llojet-speciet) janë realizuar sipas renditjes alfabetike.

“**Format korologjike**” dhe “**Format jetësore**” janë numëruar e analizuar dhe prezantohen duke u bazuar në rezultatet e arritura. Ato sqarohen përmes tabelave dhe figurave.

Punimi plotësohet me “**Fotografi të llojeve bimore**” origjinale nga puna hulumtuese në terren.

Sipas rezultateve dhe gjendjes në terren, bazuar edhe në përpunimin e rezultateve, në veçanti paraqiten **diskutimi** dhe **përfundimet**.

**Literatura** e cituar është e kohës-aktuale. Ajo është tregues i në përcjelljes së zhvillimeve të kohës sa i përket florës vaskulare në përgjithësi por edhe hulumtimeve në Rrafshin e Drenicës.

### **Vlerësimi dhe propozimi**

Punimi i masterit i kandidates **Diellza Gashi** është hulumtim floristik i arritur pas studimit në terren dhe përpunimit të materialit gjatë vitit 2024. Rezultatet e arritura janë me rëndësi për plotësimin e regjistrit të florës së Kosovës.

Komisioni për vlerësimin e këtij dorëshkrimi, e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit të


kandidates Diellza Gashi, me titull "Flora vaskulare natyrore drunore dhe shkurrore në Rrafshin e Drenicës" / "Natural woody and shrubby vascular flora in the Drenica Plain".

Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologisë si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që punimin në fjalë ta pranojë dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Biologji).


Prishtinë, 13.12.2024

Komisioni:


1.

  
/ Prof. Dr. Fadil Millaku – kryetar

2.

  
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar (mentor)/

3.

  
/ Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

